



BULETINI MUJOR I SËMUNDSHMËRISË INFEKTIVE

(Pasqyra 14/Sh)

DEPARTAMENTI I EPIDEMIOLOGJISË DHE KONTROLLIT TË
SËMUNDJEVE INFEKTIVE

GUSHT, 2019

Buletini MuJOR i Sëmundshmërisë Infektive publikohet çdo muaj nga Sektori i Survejancës dhe Shërbimit të Inteligjencës Epidemike, Instituti i Shëndetit Publik (ISHP). Ky Buletin MuJOR bazohet në të dhënat e Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS), të raportuara përmes Pasqyrës Mujore 14/Sh. Ai plotësohet në pasqyrën në formatin EXCEL, dhe dërgohet me postë elektronike dhe me postë zyrtare, brenda datës 10 të çdo muaji, në Departamentin e Epidemiologjisë dhe Kontrollit të Sëmundjeve Infektive (DEKSI), Instituti i Shëndetit Publik. Të dhënat e agreguara të Pasqyrës 14/Sh për muajin gusht 2019 janë të dhënat e raportuara nga Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) në rrethe.

1. Sëmundjet diarreike

Sëmundjet diarreike gjatë muajit gusht 2019 zënë 63% të totalit të sëmundjeve infektive, të raportuara me anë të Pasqyrës 14/Sh, dhe paraqesin një incidencë 486.44/100.000 banorë. Dihet që periudha e muajve të nxehtë të vitit mbart me vete frekuencën më të lartë të episodeve diarreike, ku në muajin gusht vihet re një tendencë në rritje e sëmundjeve diarreike. Gastroenteritet e paspecifikuara janë të shpërndara në të gjitha rrethet e vendit dhe zënë peshën kryesore në grupin e sëmundjeve diarreike. Ndërkohë që në nivel kombëtar, helmimet ushqimore paraqesin një incidencë 14.14/100.000 banorë. Rrethet Berat, Bulqizë, Kukës dhe Kavajë mbajnë peshën kryesore në raportimin e helmimeve ushqimore. Duhet theksuar që numri i lartë i rasteve të raportuara me helmime ushqimore dhe gastroenterite është i lidhur me pamundësinë në nivelin e disa rrethëve të diagnozës së saktë klinike, dhe konfirmimit të saj me diagnozën laboratorike mikrobiologjike.

Gjatë muajit gusht 2019 janë raportuar 112 raste me Salmonelozë jotofoide. Numri i lartë i rasteve lidhet me një helmim ushqimor të ndodhur në fshatin Kallm i Madh, Njësia Administrative Mbrostar Ura, Bashkia Fier, nga përgatitja e produkteve ushqimore në një ceremoni familjare, me ujë jo sipas standardit shtetëror. Në ceremoninë familjare (dasëm) merrnin pjesë 140 persona, nga të cilët 81 persona paraqitën probleme gastrointestinale: krampe abdominale, diarre e ujshme, këputje dhe dhimbje artikulacionesh. Nga analiza e mostrave të feceve të dërguara në ISHP (pa filluar mjekimin me antibiotik për të gjetur agjentin shkaktar të sëmundjes), Laboratori i Enterobaktereve pranë Departamentit të Epidemiologjisë dhe Kontrollit të Sëmundjeve Infektive, ISHP, brenda 48 orëve përcaktoi

agjentin shkaktar *Salmonella Enteritidis*. Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Fier hetoi shpërthimin dhe mori të gjitha masat.

Rrethi i Shkodrës vazhdon të mbajë peshën kryesore të incidencës së Shigelozës për muajin gusht 2019 me 44 raste (2.65/10.000 banorë), të konfirmuara në Laboratorin Mikrobiologjik të NJVKSH-së Shkodër, që u përkasin grup-moshave të ndryshme.

Gjatë muajit gusht është raportuar nga rrethi i Pogradecit një rast me diagnozë Tifo abdominale, mashkull i grup-moshës 40-44 vjeç, banor në një fshat të Pogradecit. Pacienti është shtruar në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” (QSUT) në Shërbimin e Infektivit dhe është konfirmuar me Tifo abdominale në “Laboratorin e Bakteriologjisë”, ISHP. NJVKSH Pogradec ka marrë masat përkatëse dhe nga hetimi rezultoi, që nuk ka pasur raste me gjendje febrile të zgjatur dhe gastroenterite nga ky fshat në Pogradec.

Tabela 1: Frekuencat dhe incidencat e sëmundjeve diarreike për muajin gusht 2019

(Incidenca raste/100.000 banorë)

	Raste gusht 2019	Incidenca gusht 2019 (raste/100.000 banorë)
Tifo abdominale + Paratifo	1	0.04
Salmonelozë	113	4.04
Shigelozë (Disenteri bacilare)	48	1.71
Dizenteri amebike	0	0
Helmime ushqimore	396	14.14
Gastroenterite (etiologji e panjohur)	13063	466.51
Sëmundje diarreike në total	13621	486.44


2. Sëmundjet e parandalueshme nga vaksinat (EPI)

2.1. Fruthi

Gjatë muajit gusht 2019 në kuadrin e vazhdimësisë së epidemisë së Fruthit janë dyshuar në total 6 raste prej të cilave janë konfirmuar me IgM pozitiv 2 raste. Të dyja rastet i përkasin rrethit të Tiranës dhe janë të grup-moshës 2-4 vjeç dhe mbi 45 vjeç. Gjatë muajit gusht vërehet një renie e rasteve me Fruth. Një informacion më të zgjeruar mund ta gjeni në “Buletinin Javor të Fruthit” në faqen e ISHP-së.



Grafiku 1. Kurba epidemike e rasteve të dyshuara për Fruth sipas datës së fillimit të rashit, gusht 2019



Grafiku 2. Kurba epidemike e rasteve të dyshuara për Fruth sipas datës së fillimit të rashit, gusht 2018

Në muajin gusht të vitit 2018 u raportuan në total 22 raste, prej të cilave 13 u konfirmuan nga ana laboratorike. Nga këto 11 raste i përkisnin rrethit të Tiranës. Rastet ishin të grup-moshës së rritur, kryesisht 21-26 vjeç.

Siç shihet, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë, numri i rasteve është në rënie dhe moshë pediatrike vazhdon të jetë më e prekur. Kjo për shkak edhe të mosvaksinimit dhe kontaktit, apo vizitës së mëparshme të tyre në shërbimin pediatrik të QSUT-së.

Të gjitha rastet janë konfirmuar në Laboratorin e Virologjisë, ISHP.

2.2. Tuberkulozi pulmonar

Bazuar në të dhënat e pasqyrës 14/Sh, gjatë muajit gusht 2019 janë raportuar 21 raste të reja me Tuberkuloz pulmonar (TB). Rastet pulmonare sputum pozitiv janë: 11 raste në Tiranë, 3 raste në Kukës, 4 raste në Durrës, 2 raste në Librazhd, nga 1 rast në Bulqizë.

Rastet e raportuara në muajin gusht i përkasin kryesisht moshës mbi 15 vjeç dhe shqetësues është fakti që dy raste janë në grup-moshën 1-4 vjeç dhe një rast në grup-moshën 5-9 vjeç.

Bazuar në të dhënat e pasqyrës 14/Sh, gjatë muajit gusht 2019 janë raportuar 4 raste me Tuberkuloz ekstrapulmonar të konfirmuar, përkatësisht nga 2 raste kanë raportuar rrethet Shkodër dhe Laç.

3. Zoonozat

Gjatë muajit gusht 2019 me anë të Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS), të raportuara përmes Pasqyrës Mujore 14/Sh, janë raportuar nga NJVKSH-të 8 raste me brucelozë, nga të cilat 7 raste janë të konfirmuara. Rastet janë raportuar nga rrethet Bulqizë, Delvinë, Berat, Dibër dhe Gjirokastër, dhe i përkasin grup-moshës 40-65 vjeç.

Gjatë muajit gusht 2019 janë raportuar 4 raste me Antraks kutan përkatësisht nga rrethet Librazhd, Lushnjë, Sarandë dhe Vlorë. Vetëm një rast është i konfirmuar dhe rastet me Antraks janë të grup-moshës 45-65 vjeç.

**Tabela 2: Frekuenca dhe incidencat e sëmundjeve Zoonotike në gusht 2019
(Incidenca raste/100.000 banorë)**

	Raste gusht 2019	Incidenca gusht 2019 (raste/100.000 banorë)
Antraks (Plasje)	4	0.14
Brucelozë	8	0.29
Leptospirozë	6	0.21
Leishmaniazë viscerale	1	0.04
Leishmaniazë kutane	0	0

4. Hepatitet virale

Në raportimin mujor të sëmundshmërisë infektive gjatë muajit gusht 2019 janë raportuar në total 30 raste me Hepatite Virale akute (Incidenca 1.04/100.000 banorë), nga të cilat 3 raste janë hepatite virale të paspecifikuara, 21 raste Hepatite Virale B (HBV) të konfirmuara në laboratorët e NJVKSH-së Tiranë, Durrës, Delvinë dhe Skrapar. Në lidhje me Hepatitet Virale C (HCV) në Pasqyrën 14/Sh janë raportuar 6 raste dhe është konfirmuar vetëm një rast me HCV.

5. HIV/AIDS

Në muajin gusht 2019 janë kryer në total 33 ekzaminime për HIV, 25 meshkuj dhe 8 femra. Nga këto ekzaminime, 8 prej tyre kanë rezultuar pozitive (7 meshkuj dhe 1 femër). Rastet pozitive i përkasin grup-moshave si më poshtë: 1 rast grup-mosha 16-24 vjeç, 3 raste grup-mosha 25-29 vjeç, 1 rast grup-mosha 40-44 vjeç, 1 rast grup-mosha 30-34 vjeç, 1 rast grup-mosha 35-39 vjeç dhe 1 rast grup-mosha 55-59 vjeç.

Shpërndarja sipas rretheve tregon se 5 raste i përkasin Tiranës, 1 rast Dibrës, 1 rast Durrësit dhe 1 rast i përket Shkodrës. Mostrat e gjakut që kanë rezultuar pozitive kanë ardhur në ISHP si më poshtë: 3 raste nga klinikat (dy nga Shërbimi Infektiv dhe një nga Shërbimi i Gastrohepatologjisë), 2 raste janë ndjekje epidemiologjike pas diagnozës së njërit prej partnerëve, 2 raste nga Qendra e Këshillimit dhe Testimit Vullnetar (VCT) Tiranë, 1 rast nga Qendra Kombëtare për Transfuzionin e Gjakut (QKTGJ) dhe 1 rast nga Spitali Amerikan.

INSTITUTI I
SHËNDETIT PUBLIK

DEKSI